

U dorezua ne Kuvend Projekt Ligji: PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE TË RINJVE NGA PROPAGANDA GJINORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 81 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputeteve:

Neni 1

Objekti

1. Ky ligj ka për objekt mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve deri në moshën 22 vjeç nga çdo formë përmbajtjeje, ndikimi apo propagande që trajton çështje të identitetit gjinor, seksualitetit apo ndryshimit të karakteristikave biologjike, promovimit të abortit, në mënyrë të papërshtatshme për moshën dhe nivelin e zhvillimit të tyre.

2. Në veçanti, ligji synon:

- a) të garantojë që arsimi parauniversitar të mbrojë të miturit nga ekspozimi i parakohshëm ndaj koncepteve komplekse, që lidhen me identitetin gjinor dhe seksual, largimin nga koncepti i familjes nje burre dhe nje grua, pra me prinder Nene e Baba, promovimin e abortit;
- b) të garantojë që arsimi para universitar të mbetet i fokusuar në njohuri të bazuara në standarde shkencore dhe zhvillimore, të përshtatshme për moshën;
- c) të ndalojë çdo formë ndikimi aktiv, promovimi apo orientimi që synon formësimin e bindjeve të të miturve apo të rinjve deri në moshën 22 vjeç në këto fusha;
- c) të forcojë rolin parësor të prindërve dhe familjes në edukimin moral dhe social të fëmijëve dhe të rinjve;
- d) të sigurojë që çdo ndërhyrje në zhvillimin fizik apo psikologjik të të miturve dhe të rinjve të bazohet në nevoja mjekësore të provuara dhe në përputhje me standarde të rrepta profesionale.

3. Zbatimi i këtij ligji bëhet në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe të rinjve, si dhe me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga legjislacioni në fuqi. Dispozitat që lidhen me transparencën, informimin dhe pëlqimin e informuar zbatohen edhe për të rinjtë nga 18 deri në 22 vjeç, pa cenuar lirinë akademike, lirinë e shprehjes dhe të drejtat e tjera themelore

## Neni 2

### Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) Ndalimin në arsimin parauniversitar të çdo materiali, programi, aktiviteti apo komunikimi që promovon ose prezanton në mënyrë aktive koncepte të identitetit gjinor të ndryshueshëm, ndryshimit të seksit apo forma alternative të strukturës familjare jashtë asaj tradicionale, si të papërshtatshme për moshën dhe zhvillimin e nxënësve.

b) Ndalimin e propagandës së drejtuar ndaj të miturve në mjedise publike, media, publikime apo platforma digjitale, kur kjo propagandë trajton çështje të identitetit gjinor ose seksualitetit, apo ndryshimit të konceptit të familjes nga ajo e një burri dhe një gruaje, dhe që mund të ndikojnë në zhvillimin e tyre psikologjik dhe emocional.

c) Ndalimin e pjesëmarrjes së të miturve në aktivitete, organizime apo nisma, edhe jashtëshkollore, që synojnë promovimin aktiv të çështjeve të identitetit gjinor fluid ose seksualitetit, koncepteve të familjes LGBTQ etj.

ç) Vendosjen e kufizimeve të qarta për ndërhyrjet mjekësore, invazive apo medikamentoze, si dhe psikologjike, që lidhen me ndryshimin e karakteristikave seksuale ose identitetit gjinor, duke kërkuar që çdo ndërhyrje e tillë të jetë në përputhje me moshën, pjekurinë dhe standardet ndërkombëtare objektive shkencore.

d) Garantimin e rolit të prindërve, duke bërë të detyrueshëm informimin dhe miratimin e tyre për çdo material, aktivitet apo program edukativ që trajton çështje të ndjeshme të zhvillimit personal dhe social të të miturve.

dh) Sigurimin e proporcionalitetit të masave, duke garantuar që zbatimi i këtij ligji të bëhet në respekt të të drejtave themelore. Ndalohet çdo veprim, aktivitet, material ose komunikim që synon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qëllimshme formësimin e bindjeve, qëndrimeve ose identitetit personal të fëmijëve, jashtë rolit parësor të familjes dhe në kundërshtim me përshtatshmërinë për moshën.

## Neni 3

### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet përgjegjës” është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror a vendor, i cili/të cilat, brenda fushës së veprimtarisë së tij/tyre, harton/jnë politika dhe ushtron/jnë përgjegjësitë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, kryen/jnë dhe mbulon/jnë shërbime të specializuara e profesionale për fëmijën.

2. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

3. “Pjesëmarrje e fëmijës” është një proces i vazhdueshëm i përfshirjes aktive të fëmijës dhe i respektimit të së drejtës së tij për t’u shprehur e për t’u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje që lidhen me të.

4. “Prind” është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

#### Neni 4

##### Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 22 vjeç, me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, të cilët ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 5

##### Parime të përgjithshme

1. Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës dhe të të rinjve, të përcaktuara në këtë ligj, mbështeten në këto parime:

a) Fëmija dhe i riu janë bartës të të drejtave, të cilat janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.

b) Interesi më i lartë i fëmijës dhe i të rinjve përbën konsideratën parësore në çdo veprim apo vendimmarrje që lidhet me ta.

c) Barazia dhe mosdiskriminimi garantohet për çdo fëmijë dhe të ri, pa asnjë dallim.

ç) Prindërit dhe/ose kujdestari ligjor mbajnë përgjegjësinë parësore për krijimin e kushteve të jetesës dhe për sigurimin e mirërritjes, zhvillimit, mirëqenies, edukimit dhe arsimimit të fëmijës dhe të të rinjve.

d) Çdo fëmijë dhe çdo i ri ka të drejtë të jetojë dhe të rritet në një mjedis familjar dhe shoqëror të përshtatshëm.

dh) Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës dhe të të rinjve është i garantuar në çdo rrethanë.

e) Garantohej pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës dhe të të rinjve, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tyre për të kuptuar.

2. Ky ligj sigurohen stabilitetin dhe vazhdimësinë në kujdesin, rritjen dhe edukimin e fëmijës dhe të të rinjve, duke marrë në konsideratë identitetin e tyre etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

## Neni 6

Neutraliteti ideologjik dhe gjinor në arsimin parauniversitar dhe atë universitar

1. Në sistemin arsimor parauniversitar dhe universitar në Republikën e Shqipërisë garantohej një mjedis mësimor ideologjikisht neutral, i cili respekton dallimet biologjike, dinjitetin e individit dhe vlerat themelore të familjes si bazë e shoqërisë.

2. Ndalohet përfshirja në kurrikula, tekste, materiale didaktike, aktivitete shkollore apo jashtëshkollore, si dhe çdo aktivitet tjetër arsimor, e koncepteve, praktikave apo përmbajtjeve që promovojnë ose prezantojnë në mënyrë aktive:

a) relativizmin gjinor;

b) idetë që sugjerojnë se gjinia është konstrukt shoqëror i ndryshueshëm nga seksi biologjik;

c) ndryshimin e karakteristikave seksuale;

ç) struktura alternative të familjes që nuk përputhen me konceptin tradicional të prindit, nënës dhe babait;

d) promovimin e abortit.

3. Ndalohet çdo veprim, aktivitet, material ose komunikim në kuadër të procesit arsimor që synon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qëllimshme formësimin e bindjeve, qëndrimeve ose identitetit personal të fëmijëve dhe të rinjve, jashtë rolit

parësor të familjes dhe në kundërshtim me përshtatshmërinë për moshën dhe zhvillimin e tyre psikologjik e emocional.

4. Përdorimi i simbolikës, terminologjisë apo formave gramatikore që shmangin gjininë binare (mashkull/femër) në dokumentacionin zyrtar, materialet didaktike apo aktivitetet arsimore, është i ndaluar në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar dhe universitar.

5. Organet arsimore, institucionet dhe personeli pedagogjik janë të detyruar të sigurojnë zbatimin e këtij neni, duke verifikuar përmbajtjet mësimore dhe aktivitetet, si dhe duke njoftuar autoritetet kompetente për çdo shkelje të mundshme.

6. Shkelja e dispozitave të këtij neni përbën kundërvajtje administrative dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi, duke përfshirë vendosjen e sanksioneve për individët ose institucionet përgjegjëse.

Neni 7

Transparenca dhe marrja e pëlqimit paraprak të prindërve

1. Institucionet arsimore parauniversitare kanë detyrimin ligjor të bëjnë transparente për prindërit të gjitha materialet didaktike, kurrikulat, modulet plotësuese, tekstet shkollore dhe materialet audiovizuale që trajtojnë seksualitetin, orientimin seksual ose identitetin gjinor.

2. Çdo aktivitet, mësimdhënie, leksion ose projekt që lidhet me edukimin seksual, shëndetin riprodhues ose orientimin seksual në arsimin parauniversitar duhet të njoftohet zyrtarisht tek prindërit të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara zhvillimit. Gjatë këtij afati, prindërit kanë të drejtë të kërkojnë sqarime shtesë, të shohin prezantimet ose materialet shpërndarëse dhe të konsultohen me mësuesit dhe drejtuesit e institucionit arsimor mbi përshtatshmërinë e materialit me moshën e fëmijës.

3. Pjesëmarrja e nxënësve në këto aktivitete nuk lejohet pa dorëzimin paraprak të një pëlqimi/autorizimi me shkrim nga prindi ose kujdestari ligjor. Formulari i dhënies së pëlqimit/autorizimit miratohet me urdhër të përbashkët të Ministrit përgjegjës për arsimin, Ministrit përgjegjës për fëmijët dhe rininë, dhe Ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Refuzimi i prindërit ose kujdestarit ligjor për pjesëmarrjen e fëmijës në aktivitete të caktuara nuk mund të sjellë pasoja negative akademike, disiplinore ose forma diskriminimi ndaj fëmijës.

4. Fshehja e materialeve, prezantimi i informacionit pa njohurinë paraprake të prindërve, ose anashkalimi i afatit 30-ditor përbëjnë shkelje të rëndë disiplinore për mësuesit dhe drejtuesit e institucionit, si dhe japin të drejtën për padi civile nga prindërit për shkelje të të drejtave të garantuara nga ky ligj.

5. Vetëm organizmat apo entitetet e autorizuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin, pas një kontrolli të rreptë të materialeve të tyre, mund të ofrojnë trajnime të jashtme në institucione arsimore. Çdo aktivitet i jashtëm që promovon relativizmin gjinor ose idetë që sugjerojnë se gjinia është konstrukt shoqëror i ndryshueshëm nga seksi biologjik, lirinë e abortit tek të miturit ose nxënësit, është i ndaluar.

Neni 8

Ndalimi i përmbajtjeve dhe propagandës së papërshtatshme për të miturit dhe të rinjtë në media dhe hapësira publike

1. Ndalohet shpërndarja, transmetimi ose publikimi në radio, televizion, platforma online, rrjete sociale, botime të shtypura, si dhe në çdo formë tjetër komunikimi publik, i përmbajtjeve që trajtojnë ose promovojnë çështje të identitetit gjinor, seksualitetit apo ndryshimeve të karakteristikave biologjike, kur këto përmbajtje, për shkak të përmbajtjes, gjuhës ose formës së paraqitjes, nuk janë të përshtatshme për moshën e fëmijëve dhe të rinjve

2. Ndalohet në mënyrë të posaçme çdo shpërndarje ose promovim i përmbajtjeve që synojnë drejtpërdrejt të miturit dhe që, për shkak të përmbajtjes, gjuhës ose formës së paraqitjes, nuk janë të përshtatshme për zhvillimin e tyre fizik, psikologjik dhe moral.

3. Ky ndalim zbatohet në çdo ambient publik ose të aksesueshëm nga të miturit, përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) hapësirat publike të hapura;

b) institucionet arsimore;

c) mjediset kulturore, sportive dhe rekreative;

ç) platformat digjitale dhe mediat audiovizive.

4. Subjektet që ofrojnë shërbime mediatike, botime dhe publikime, si dhe platformat digjitale, janë të detyruara të marrin masa efektive për:

- a) kufizimin e aksesit të të miturve në përmbajtje të papërshtatshme për moshën;
- b) klasifikimin dhe sinjalizimin e qartë të përmbajtjeve sipas grupmoshave;
- c) zbatimin e mekanizmave të verifikimit të moshës dhe filtrimit të përmbajtjes;
- ç) shmangien e çdo forme promovimi aktiv të këtyre përmbajtjeve ndaj të miturve.

5. Çdo formë organizimi, promovimi apo shpërndarjeje e përmbajtjeve të tilla, e drejtuar në mënyrë specifike ndaj të miturve ose e aksesueshme lehtësisht prej tyre, konsiderohet shkelje e këtij ligji dhe sanksionohet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

6. Zbatimi i këtij neni bëhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe në respekt të lirisë së shprehjes, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen efektive të zhvillimit fizik, psikologjik dhe moral të fëmijëve dhe të rinjve..

## Neni 9

Kufizimi i pjesëmarrjes së të miturve dhe të rinjve në aktivitete

1. Ndalohet përfshirja, organizimi ose nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve deri në moshën 18 vjeç në aktivitete, organizime ose nisma publike që trajtojnë ose promovojnë në mënyrë aktive çështje të identitetit gjinor, seksualitetit apo tema të tjera të ndjeshme të zhvillimit personal, kur këto nuk janë të përshtatshme për moshën dhe nivelin e pjekurisë së tyre.

2. Organizatorët e aktiviteteve publike janë të detyruar të marrin masa për:

a) verifikimin e moshës së pjesëmarrësve;

b) përcaktimin e qartë të natyrës së aktivitetit dhe përmbajtjes së tij;

c) ndalimin e aksesit të të miturve dhe të rinjve në rastet kur përmbajtja është e papërshtatshme për ta.

3. Pjesëmarrja e të miturve dhe të rinjve në aktivitete që përfshijnë trajtimin e çështjeve të ndjeshme lejohet vetëm pas dorëzimit të pëlqimit të shprehur me shkrim nga prindi ose kujdestari ligjor.

4. Ndalohet çdo formë ndikimi, presioni ose përfshirjeje e drejtpërdrejtë e të miturve dhe të rinjve nën moshën 18 vjeç në aktivitete që synojnë formësimin e bindjeve të tyre në këto fusha, në kundërshtim me interesin më të lartë të tyre.

5. Shkelja e dispozitave të këtij neni përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Kufizimi i ndërhyrjeve për ndryshimin e karakteristikave seksuale biologjike

1. Ndalohet kryerja e çdo ndërhyrjeje medikamentoze, kirurgjikale, invazive ose jo invazive, si dhe çdo ndërhyrjeje me natyrë psikologjike ose terapeutike, e cila synon ndryshimin e karakteristikave seksuale biologjike të individëve nën moshën 22 vjeç.

2. Për qëllimet e këtij ligji, ndërhyrje të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen në:

a) administrimin e hormoneve apo medikamenteve që ndikojnë në zhvillimin seksual;

b) procedura kirurgjikale që synojnë ndryshimin e karakteristikave seksuale;

c) trajtime të tjera mjekësore, psikologjike ose terapeutike që kanë si qëllim transformimin e karakteristikave seksuale biologjike apo të identitetit të lidhur me to.

3. Ndalohet në mënyrë të posaçme kryerja e ndërhyrjeve të parashikuara në pikën 1 ndaj fëmijëve, përveç rasteve kur ekziston një indikacion i qartë mjekësor, i dokumentuar dhe i bazuar në standarde të pranuar ndërkombëtare, dhe kur ndërhyrja është e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit fizik të tyre.

4. Në çdo rast përjashtimor, vendimi për lejimin e ndërhyrjes merret nga një komision multidisiplinar i pavarur, i përbërë nga specialistë të fushave përkatëse, i cili vepron në përputhje me procedurat e përcaktuara me akte nënligjore dhe bazuar në:

a) parimin e kujdesit dhe të parandalimit të dëmit;

b) interesin më të lartë të fëmijës;

c) vlerësimin e plotë mjekësor, psikologjik dhe zhvillimor të individit.

5. Çdo ndërhyrje e kryer në kundërshtim me dispozitat e këtij neni konsiderohet shkelje e rëndë dhe sjell përgjegjësi:

a) administrative, sipas legjislacionit në fuqi;

b) penale, kur ligji e parashikon, për individët ose subjektet përgjegjëse.

6. Zbatimi i këtij neni bëhet duke respektuar interesin më të lartë të të riut dhe parimin e mbrojtjes së shëndetit, duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit fizik, hormonal dhe psikologjik të individit, si dhe standardet e pranuar ndërkombëtare në fushën e mjekësisë.

Neni 11

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

**1. Shkeljet e nenit mbi ndalimin e propagandës gjinore dhe ideologjive të papërshtatshme në arsimin parauniversitar dhe universitar:**

- a) Personi fizik: gjobë nga 50.000 deri në 100.000 lekë;
- b) Personi juridik (institucione arsimore, organizata publike/private): gjobë nga 100.000 deri në 200.000 lekë;
- c) Pedagogët, mësuesit ose punonjësit e tjerë që veprojnë në kundërshtim me këtë nen: gjobë nga 60.000 deri në 120.000 lekë.

**2. Shkeljet e nenit mbi ndalimin e propagandës në media, internet dhe ambiente publike:**

- a) Personi fizik që shpërndan ose promovon përmbajtje të ndaluara: gjobë nga 40.000 deri në 80.000 lekë;
- b) Subjektet mediatike, platforma online ose organizatat që lejojnë shpërndarje të përmbajtjeve: gjobë nga 100.000 deri në 250.000 lekë;
- c) Përgjegjësit editorialë ose drejtuesit e platformave: gjobë nga 60.000 deri në 120.000 lekë.

**3. Shkeljet e nenit mbi kufizimin e pjesëmarrjes së të rinjve nën 22 vjeç në aktivitete propagandistike:**

- a) Organizatorët e aktiviteteve që përfshijnë fëmijë ose të rinj nën 22 vjeç pa pëlqimin e prindërve: gjobë nga 50.000 deri në 150.000 lekë;
- b) Institucionet ose organizatat që nuk mbikëqyrin dhe nuk zbatojnë kufizimin: gjobë nga 100.000 deri në 250.000 lekë.

**4. Shkeljet e nenit mbi ndërhyrjet medikamentoze, kirurgjikale, invazive ose psikologjike për ndryshimin e karakteristikave seksuale të të rinjve nën 22 vjeç:**

- a) Personi fizik (mjek, psikolog, apo profesionist tjetër): gjobë nga 200.000 deri në 500.000 lekë, pezullim i lejes së ushtrimit të profesionit deri në 12 muaj;
- b) Institucioni shëndetësor ku kryhet ndërhyrja: gjobë nga 500.000 deri në 1.000.000 lekë, pezullim i aktivitetit të përkohshëm deri në 6 muaj;
- c) Për çdo ndërhyrje e kryer në kundërshtim me nenin, individi dhe institucioni mbajnë përgjegjësi civile dhe penale sipas legjislacionit në fuqi.

5. Shkeljet e nenit mbi të drejtën e prindërve për informim dhe dhënien e dakordësisë:

- a) Subjektet që nuk informojnë ose nuk marrin dakordësinë e prindërve për aktivitete, ndërhyrje ose përmbajtje për fëmijët dhe të rinjtë nën 22 vjeç: gjobë nga 50.000 deri në 150.000 lekë;
- b) Në rast përsëritjeje, mund të urdhërohet ndalimi i aktivitetit dhe detyrimi për kompensim për dëmin material dhe moral të shkaktuar.

6. Përsëritja e kundërvajtjeve mund të çojë në masa më të rënda administrative, përfshirë pezullim aktiviteti, mbyllje përkohshme të institucionit ose platformës, dhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë për individët përgjegjës.

Neni 12

Aktet nënligjore

Brenda dy (2) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miratohet, me urdhër të përbashkët të Ministrit përgjegjës për arsimin, Ministrit përgjegjës për fëmijët dhe rininë, si dhe Ministrit përgjegjës për shëndetësinë, formulari i dhënies së pëlqimit/autorizimit, në përputhje me përcaktimet e Nenit 7 të këtij ligji.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.